

KRITERET E VLERESIMIT
PER PROGRAMET E CIKLIT TE DYTE TE STUDIMEVE
“MASTER I NIVELIT TE PARE” - MNP

A - BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë”, i ndryshuar; Udhëzimi Nr.15, datë 04.04.2008 të MASH “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, Udhëzimi Nr.4, datë 22.01.2008 i MASH “Për Hapjen Mbylljen dhe riorganizimin e Programeve të Studimit Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë” dhe Udhëzimi Nr. 30, datë 26.09.2007 i MASH “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë ose Programeve të reja të Studimit në Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 29 dt 28.07.2008 të MASH.

B – DOKUMENTACIONI

Për vlerësimin e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me Diplomë “Master i Nivelit të Parë” (MNP), Institucioni i Arsimit të Lartë paraqet dosjen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. MASH, dërgon për vlerësim në Agjencinë Publike të Arsimit të Lartë dokumentacionin përkatës i cili duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1 Argumentimin për Programin e ri të studimit
- 2 Organizimin e Studimit
- 3 Planin Mësimor
- 4 Syllabuset e lëndëve/moduleve
- 5 Rregulloren e programit të studimit
- 6 Personelin Akademik në funksion të Programit të studimit
- 7 Shtojca sipas MASH, e plotësuar

Në rast se dokumentacioni nuk përfshin të gjitha sa më sipër, dosja rikthehet në MASH pa vlerësim.

C – PERMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Çdo dokument apo e dhënë sipas B, duhet të përmbajë detyrimisht të dhënat e kërkuara si më poshtë:

C.I. ARGUMENTIMI PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT

Institucioni kërkues duhet të argumentojë qartë nevojën për hapjen e këtij programi, kërkesat e tregut të punës për programin përkatës dhe kapacitetet mbështetëse të institucionit që garantojnë realizimin cilësor të këtij programi.

Në argumentim të jepen edhe referencat e programeve analoge të institucioneve të tjera (brenda ose jashtë vendit), të cilat janë konsultuar apo shfrytëzuar si modele gjatë hartimit të programit të propozuar.

C.II. ORGANIZIMI I STUDIMIT

1. Organizimi i Programit të Studimit

IAL, përkundrejt standardeve ekzistuese për organizimin e studimeve të ciklit të dytë të studimit që përfundojnë me diplomë “Master i Nivelit të Parë”, duhet të përcaktojë qartë sa më poshtë,:

- a) Cikli i studimit: Cikli i II-të i studimit
- b) Emërtimi i Diplomës: Master i Nivelit të Parë:....
- c) Kohëzgjatja e Programit të Studimit: 1 vit/2 semestra
- d) ECTS totale : 60 ECTS
- e) Forma e studimit; kohë të plotë, të pjesshme, në distancë, tjetër.

2. Program studimi i organizuar nga vetë subjekti/IAL apo në bashkëpunim me Institucione të tjera

- a) IAL duhet të përcaktojë qartë nëse programet e studimit i ofron e vetme apo në bashkëpunim me IAL të tjera vendase/të huaja
- b) Në rastin e bashkëpunimit me të tjerë duhet të tregohen qartë IAL-të bashkëpunuese dhe të shoqërohen me dokumenta që dëshmojnë formën dhe mënyrat e bashkëpunimit.

3. Çfarë garanton Programi i Studimit?

Programi i studimit që përfundon me Master i Nivelit të Parë duhet të garantojë: Arsimim dhe trajnim profesional, në përputhje me tregun e punës së fushës përkatëse të programit

C.III. PLANI MËSIMOR

1. Elementët përbërës të Planit Mësimor

Plani mësimor duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm të cilat duhet të jenë në përputhje me kriteret përkatëse për secilin element, si më poshtë:

- a) Vit/Semestra- 1 vit/2 semestra
- b) Kredite në vit – mesatarisht 60 ECTS
- c) Numri i Lëndëve/moduleve
- d) Numri total i provimeve- (jo më shumë se 8 provime)
- e) Ngarkesa totale në auditor/vit: nga 600-750 orë mësimore
- f) Ngarkesa në orë mësimore javore: 20-25 orë në javë
- g) Ngarkesa totale jashtë auditorit / vit: nga 750- 900 orë punë mësimore e studentit
- h) Format e mësimdhënies; duhet të parashikohen disa forma mësimdhënie; ato duhet të jene të ndara qartë në planin mësimor për çdo lëndë/modul apo aktivitet tjetër formues.
- i) Kreditet korresponduese për çdo lëndë/modul apo aktivitet tjetër formues.

2. Mbështetja në ciklin e parë të studimeve

Një Program Studimi që përfundon me Master i Nivelit të Parë duhet:

- Të reflektojë kërkesat e tregut dhe bashkëpunimin me tregun dhe profesionet në nivel kombëtar dhe lokal.

3. Ndarja e lëndëve/ moduleve sipas veprimtarive formuese

Për çdo program studimi MNP, veprimtaritë formuese të domosdoshme për t'u ndjekur duhet të grupohen në veprimtaritë formuese, të shoqëruara me ngarkesën në ECTS:

- Aktivitete formuese në auditor
- Trajnim/praktikë
- Prova finale: mikrotezë/testim

4. Frekuentimi aktiviteteve të ndryshme formuese nga student

Frekuentim nga studentët i aktiviteteve formuese në auditor duhet të jetë të paktën në masën 80%.

5. Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies

Institucioni duhet të paraqesë në mënyrë të ndarë ngarkesën mësimore në orë dhe kredite dhe sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë/modul*.

Format e mësimdhënies të paraqitura duhet të shoqërohen me orët përkatëse në auditor dhe jashtë auditorit.

- Leksione
- Seminare
- Laboratore
- Ushtrime
- Trajnim/praktikë mësimore ose profesionale
- Prova finale: mikrotezë

**1 krediti të formimeve universitare i korespondojnë rreth 25 orë mësimore punë totale të studentit. 1 ECTS duhet të barazohet me rreth 10-12 orë mësimore në auditor*

6. Aftësimi Profesional

Institucioni duhet të deklarojë se ku dhe si do të zhvillohet Praktika apo Stazhi Profesional. Në mbështetje të saj duhet të paraqiten marrëveshje që IAL bën me institucione të tjera, që garantojnë realizimin e praktikës e aftësimin praktik e profesional

7. Kushtet e pranimit dhe vazhimit të studimeve në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë që përfundojnë me diplomë “Master i Nivelit të Parë”

Institucioni duhet të parashikojë dhe paraqesë

Listën e programeve të studimit të ciklit të parë (DNP) apo Diploma të tjera që mundësojnë pranimin në Programin e MNP nga i njëjti institucion dhe/ose Institucione të tjera.

8. Kriteret dhe kushtet për regjistrimin, përzgjedhjen dhe transferimin e studentëve

Institucioni duhet të parashikojë dhe paraqesë kushtet dhe kriteret për aplikimin, përzgjedhjen, regjistrimin dhe transferimin e studentëve:

a. *Kriteret për regjistrimin e studentëve:*

Në MNP regjistrohen persona që zotërojnë:

- Diplomë të nivelit të parë në fusha që lejojnë kualifikimin e mëtejshëm, (e linjës)
- Regjistrohen edhe studentë të diplomuar në programe të afërta studimi të ciklit të parë
- Diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi
- Një program studimi të ciklit të dytë

b. *Kriteret specifike akademike për pranimin e studentëve:*

- Në programet e studimit “MNP” pranohen vetëm ata persona të cilët plotësojnë kriteret akademike të përcaktuara nga institucioni, bazuar në ligjin për arsimin e lartë, i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
- Institucioni duhet të ketë kriteret minimale akademike përzgjedhëse për studentët, që jo detyrimisht janë të varur nga kuota e paracaktuar e pranimi.

c. *Modalitetet për transferimin e studentëve dhe procedurat e pranimi të studentëve dhe të njohjes së krediteve universitare të fituara më parë prej tyre*

Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin institucion, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një institucion tjetër të arsimit të lartë, bëhet nga njësia që pret studentin, me procedura dhe kriteret të përcaktuara në Rregulloren e PS dhe të publikuara paraprakisht.

9. Të dhëna për Komitetin Shkencor (KSH) dhe Koordinatorin e Programit

- a) Përbërja e KSH: KSH duhet të përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik;
- b) Një nga antarët e Komitetit Shkencor duhet të jetë përzgjedhur si koordinator i programit të kërkuar;
- c) Institucioni duhet të sjellë të dhëna për kualifikimin e anëtarëve të KSh; tituj/grada, strukturën të cilës i përket, detyra funksionale, sektori mësimor – kërkimor. Anëtarët e Komitetit Shkencor të kenë minimalisht gradën Doktor.

C.IV. SYLLABUSET E LËNDËVE/MODULEVE

1. Të gjitha lëndët/modulet duhet të jenë të shoqëruara me syllabuset përkatëse.

2. Çdo syllabus duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

- a) Emërtimi i lëndës/modulit
- b) Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- c) Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- d) Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- e) Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- f) Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik

- g) Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- h) Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- i) Format e vlerësimit të studentëve
- j) Detyrimet e studentit për lëndën
- k) Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

C.V. RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Çdo kërkesë për hapjen e një programi të ri studimit duhet të shoqërohet me Rregulloren përkatëse të programit. Kjo rregullore duhet të mbështetet në rregulloren e përgjithshme dhe atë të programeve të të njëjtit nivel të institucionit aplikues.

2. Rregullorja e Programit të Studimit duhet të përmbajë elementët me të dhënat si më poshtë:

- a) Lista e disiplinave mësimore të ndara në module, si dhe veprimtaritë e tjera formuese
- b) Objektivat formues specifike të çdo disipline apo veprimtaritë e tjera formuese
- c) Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disipline mësimore apo veprimtari tjetër formuese
- d) Kurrikulat e ofruara studentëve
- e) Formën/format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët
- f) Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin
- g) Kushtet për procedurat e modalitetet për aplikimin, përzgjedhjen, regjistrimin, njohjen e krediteve të mëparshme dhe transferimin e studentëve, etj.

C.VI. PERSONELI AKADEMIK QË MBULON PROGRAMIN E STUDIMIT

1. Të dhëna të përgjithshme për Personelin akademik në funksion të programit të studimit

Subjekti/IAL duhet të sjellë një listë zyrtare me të dhëna të plota dhe të sakta për personelin akademik përgjegjës për çdo program studimi. Këto duhet të shoqërohen me jetëshkrimin e çdo antari dhe kopje të dokumentit të kualifikimit të secilit. Për stafin me kontratë (të jashtëm) këto të dhëna duhet të shoqërohen dhe me një deklaratë personale të tyre si dhe lejen e punëdhënësit të institucionit, ku është i punësuar me kohë të plotë. Të paktën 50% e stafit që mbulon programin e studimit MNP duhet të jetë personel efektiv.

2. Kualifikimi i personelit akademik që mbulon programin e studimit

Të dhënat e personelit akademik duhet të përfshijnë identitetin e çdo antari të stafit akademik që mbulon këtë program studimi. Duhet të përcaktohen qartë dhe me përgjegjësi institucionale antarët efektivë (të brendshëm), ata me kontratë (të jashtëm), dhe shkalla e kualifikimit të tyre minimalisht Master (grada, tituj).

3. Personeli akademik përgjegjës për çdo lëndë

IAL duhet të parashikojë dhe paraqesë personat përgjegjës për çdo lëndë/modul që përmban plani mësimor i propozuar, fusha e specialitetit të secilit dhe argumentimin se si përputhet fusha e specializimit të secilit antar të personelit akademik të propozuar me lëndën/modulin që mbulon.

D: VLERËSIMI NË PËRMBAJTJE I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME EKSPERTË TË FUSHËS

Vlerësimi në përmbajtje i propozimit për Programin e ri të Studimit bëhet nga dy ekspertë të pavarur të fushës që mbulon programi dhe që vlerësojnë në mënyrë anonime dhe të pavarur nga njëri tjetri. Ekspertët vlerësojnë të gjithë dokumentacionin e paraqitur, duke ju përgjigjur qartë pyetjeve të mëposhtme për çdo aspekt që vlerësohet.

1. Elementët e programit të studimit

- a. *A janë misioni dhe objektivat e Programit Studimit të tilla që të japin dije aftësi dhe kompetenca të përshtatshme për këtë program?*
- b. *A vjen ky program si kërkesë e tregut të punës: lokal dhe kombëtar?*
- c. *Është i bazuar programi në një konceptim didaktik elastik që lejon lëvizshmëri akademike?*
- d. *A jep struktura e programit mundësi të mjaftueshme për studim të pavarur, reflektim, analizë nga ana e studentit?*
- e. *A është sistemi i studimit të propozuar (kohë e plotë, e pjesshme, në distancë, tjetër i përshtatshëm për llojin dhe nivelin e programit të studimit?)*

2. Përmbajtja e programit të studimit

- a. *A është e përshtatshme strukturimi i lëndëve/moduleve krahasuar me objektivat formuese dhe emërtimin e diplomës?*
- b. *Janë të përcaktuara qartë lëndët/modulet dhe ngarkesa e tyre relative? Është e përshtatshme kjo ndarje për programin specifik?*
- c. *Janë përcaktuar qartë format e mësimdhënies dhe a janë ato në raport të përshtatshëm e të përputhshëm me praktikën më të mirë kombëtare e ndërkombëtare për këtë program studimi?*
- d. *Është dhënë i plotë dhe i qartë Plani Mësimor në ngarkesat fizike në auditor dhe jashtë auditorit si dhe midis formave të mësimdhënies për çdo lëndë/modul?*
- e. *Është shpërndarja e ECTS-ve e përshtatshme dhe e kuptueshme? Si është ajo e krahasuar me praktikën më të mirë në fushën përkatëse?*
- f. *Cili është raporti orë mësimi në auditor/punë e pavarur e studentit? A është ky i përshtatshëm për programin në fjalë?*
- g. *Janë sjellë të plota syllabuset e lëndëve/moduleve? Cili është vlerësimi juaj për elementët përbërës?*
- h. *Programet e lëndëve/moduleve janë të përshtatshme dhe në koherencë me objektivat formuese të programit?*
- i. *A garanton programi i studimit MNP arsimim dhe trajnim profesional në përputhje me tregun e punës në fushën përkatëse?*

- j. A janë të konceptuara të tilla lëndët dhe programet e lëndëve që i japin studentit një formim të integruar dhe bashkëkohor?*
- k. Është programi dhe përmbajtja akademike lehtësisht i kuptueshëm për studentët?*
- l. Është ngarkesa e punës e kërkuar për realizimin e programit akademik e përballueshme për studentët?*

3. Personeli akademik në funksion të Programit të Studimit

- a. A mbulohet programi i ri i studimit me staf akademik të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për këtë program studimi?*
- b. A ka stafi kualifikimin e nevojshëm për të ofruar në mënyrë cilësore këtë program studimi?*
- c. A përputhet fusha akademike e formimit të përgjithshëm dhe të veçantë të stafit, si dhe përvoja e tyre kërkimore me planin mësimor të programit të studimit?*

Tiranë, më 30.01.2009